

20261381995

Në bazë të nenit 16, paragrafi 1, nënparagrafi 6 të Ligjit të Menaxhimit të Pasurisë së Konfiskuar, Dobisë Pasurore dhe Gjësëndeve të Konfiskuara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse (*) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 64/24, 37/25, 86/25, 101/25 dhe 135/25) dhe në pajtim me nenin 15, paragrafi 1, nënparagrafi 6 të Statutit të Agjencisë së Menaxhimit të Pasurisë së Sekuestruar nr. 02-4368/2 të datës 2.12.2024, Këshilli Drejtues i Agjencisë së Menaxhimit të Pasurisë së Sekuestruar, në seancën e 8-të për vitin 2026, të mbajtur më 27.5.2026, miratoi këtë

RREGULLORE PËR MËNYRËN E DHËNIES NË PËRDORIM TË GJËSENDEVE TË SEKUESTRUARA PËRKOHËSISHT, SI DHE TË PASURISË SË KONFISKUAR DHE GJËSENDEVE TË KONFISKUARA ORGANEVE SHTETËRORE, SHOQATAVE DHE FONDACIONEVE

Neni 1

Me këtë rregullore rregullohet mënyra e dhënies në përdorim të gjësëndeve të sekuestruara përkohësisht, si dhe të pasurisë së konfiskuar dhe gjësëndeve të konfiskuara organeve shtetërore, shoqatave dhe fondacioneve, në pajtim me Ligjin e Menaxhimit të Pasurisë së Konfiskuar, Dobisë Pasurore dhe Gjësëndeve të Konfiskuara në Procedurë Penale dhe Kundërvajtëse (*) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 64/24, 37/25, 86/25, 101/25 dhe 135/25).

Neni 2

Të drejtën e përdorimit të gjësëndeve të sekuestruara përkohësisht, si dhe të pasurisë së konfiskuar dhe gjësëndeve të konfiskuara, e kanë organet shtetërore, shoqatat e regjistruara të qytetarëve dhe fondacionet që veprojnë në interes publik dhe jofitimprurës.

Neni 3

Gjësendet e sekuestruara përkohësisht, si dhe pasuria e konfiskuar dhe gjësendet e konfiskuara, mund të jepen në përdorim nëse janë funksionale dhe të përshtatshme për aktivitetet e organit shtetëror, shoqatës ose fondacionit.

Neni 4

Vendimin për dhënien në përdorim të gjësëndeve të sekuestruara përkohësisht, si dhe të pasurisë së konfiskuar dhe gjësëndeve të konfiskuara, e miraton Këshilli Drejtues i Agjencisë së Menaxhimit të Pasurisë së Sekuestruar.

Neni 5

Organet shtetërore, shoqatat dhe fondacionet paraqesin kërkesë me shkrim, e cila përmban të dhëna për organizatën, qëllimin e përdorimit dhe periudhën e përdorimit.

Në kërkesë detyrimisht duhet të theksohet qëllimi i përdorimit, periudha e përdorimit dhe përshkrimi i pasurisë së nevojshme.

Neni 6

Agjencia bën kontrollimin e përmbushjes së kushteve dhe përcakton përshtatshmërinë e kërkesës.

Agjencia bën vlerësimin nëse pasuria e konfiskuar dhe gjësendet e konfiskuara janë të përshtatshme për dhënie në përdorim dhe kontrollon gjendjen e tyre.

Neni 7

Gjësendet e sekuestruara përkohësisht, si dhe pasuria e konfiskuar dhe gjësendet e konfiskuara, jepen në përdorim pa kompensim, përveç nëse me vendim të veçantë përcaktohet ndryshe.

Neni 8

Organet shtetërore, shoqatat dhe fondacionet janë të detyruara t'i përdorin gjësendet e sekuestruara përkohësisht, si dhe pasurinë e konfiskuar dhe gjësendet e konfiskuara, ekskluzivisht për qëllimin e përcaktuar në kërkesë dhe t'i mirëmbajnë në gjendje të rregullt.

Neni 9

Organet shtetërore, shoqatat dhe fondacionet nuk kanë të drejtë t'ua japin në përdorim organeve dhe institucioneve të tjera shtetërore gjësendet e sekuestruara përkohësisht, si dhe pasurinë e konfiskuar dhe gjësendet e konfiskuara.

Neni 10

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Pas hyrjes në fuqi, kjo rregullore do të publikohet edhe në faqen e internetit të Agjencisë.

Nr. 02-2557/1
27.5.2026
Shkup

Agjencia për Menaxhimin e
Pronës së Konfiskuar
Këshilli Drejtues
Kryetari,
Станко Китаноски, d.v.